VENDIM
Nr.849, datë 13.12.2006

PËR NJË SHPËRBLIM TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE TË QENDRËS KOMBËTARE ARSIMORE TË VLERËSIMIT DHE PROVIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për buxhetin e shtetit, të vitit 2006", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin e 12 (dymbëdhjetë) punonjësve të Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe Provimeve, për punën e kryer për realizimin e Maturës Shtetërore, deri në 5 (pesë) paga mujore, në varësi të kontributit të secilit.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga të ardhurat e realizuara për vitin 2006, nga Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe Provimeve.

3. Ngarkohet Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe Provimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha